



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KKDM/Nr. ³⁵ Prot
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më 21 / 2 / 2023

VENDIM

Nr. 08, datë 21/02/2023

PËR

**STANDARTIN TEKNIK SHTETEROR TE PROJEKTIMIT DHE KONTROLLIT TE DIGAVE
ME MATERIAL VENDI**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 8681, datë 02.11.2000 "Për Projektimin, Ndërtimin, Shfrytëzimin dhe Mirembajtjen e Digave dhe Dambave", Neni 4, Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) në mbledhjen e datës 21.02.2023 mori në shqyrtim çështjen e standartit teknik shtetëror për projektimin dhe monitorimin e digave të mëdha me material vendi dhe veprave hidroteknike të tyre.

Gjatë diskutimeve, antarët e KKDM theksuan problematikat e digave me material vendi ku afro 150 prej tyre janë ndërtuara më se 50 vjet më parë dhe që përdoren kryesisht për ujitje. Në këto diga përvec moshës së madhe të tyre dhe mungesës së një mirembajtje dhe monitorimi bashkëkohor janë vërejtur edhe probleme të mëdha teknike në të gjitha elementet e tyre të cilat kërkojnë një rivlerësim të gjendjes teknike si dhe marrjen e masave përmirësuese për zgjatjen e jetëgjatësisë së tyre.

Antarët e KKDM ngritën shqetësimin e rishikimit të kushteve teknike shtetëror ekzistues për digat me material vendi për projektimin e digave të reja si dhe për monitorimin, sigurinë dhe projektet e rehabilitimit të digave ekzistuese në vendin tonë. Ky standard është miratuar afro 35 vite më parë dhe nuk i ka përfshirë rekomandimet e reja të ICOLD për digat me material vendi që janë botuar pas vitit 2000. Në diskutime u vu theksi tek domosdoshmëria e një standarti të ri bashkëkohor duke u bazuar në eksperiencat e vendeve europiane dhe rekomandimet e reja të ICOLD të dhëna në Buletinet përkatëse Standardi i ri duhet të synojë zëvendësimin e kushteve teknike në fuqi të projektimit të digave me material vendi, të cilat nuk janë rishikuar që prej 35 vitesh, me standarte të reja teknike për t'u zbatuar në fushën e projektimit të tyre, rehabilitimit si dhe të kontrollit të sigurisë së digave. Bazuar në situatën aktuale, Antarët e KKDM ranë dakord për domosdoshmërinë e hartimit dhe miratimit zyrtar të standartit teknik shtetëror në lidhje me normat e kërkuara për projektimin e digave të reja me material vendi, rehabilitimin dhe monitorimin e digave ekzistuese me materialvendi si dhe në sigurinë e digave ekzistuese në vendin tonë sipas legjislacionit në fuqi nga institucionet përgjegjëse.

Në mbështetje të Ligjit Nr. 8681, datë 02.11.2000 "Për Projektimin, Ndërtimin, Shfrytëzimin dhe Mirembajtjen e Digave dhe Dambave", Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha,

VENDOSI:

1. Ti kërkoj Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë përgatitjen e Standartit Teknik Shtetëror për Projektimin dhe Monitorimin e Digave me material vendi që duhet të përdoret në projektimin e digave të reja me material vendi, në projektet e rehabilitimit të digave të mëdha ekzistuese me material vendi si dhe në monitorimin e tyre .
- 1- KKDM mbështet këtë proces me ekspertë të fushës dhe përmes bashkëpunimit me institucione kërkimore-shkencore me eksperiencë në fushën e përgatitjes së standarteve teknike Ky proces dhe Standarti Teknik përkatës do të shqyrtohet dhe miratohet në KKDM si dhe institucionet shtetërore përkatëse sipas legjislacionit në fuqi

Ngarkohet Sekretariati Kombëtar i Digave të Mëdha (SKDM) si zyrë ekzekutive e KKDM për ndjekjen dhe zbatimin e masave të kërkuara në këtë Vendim sipas legjislacionin në fuqi.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KRYETARI

Arjan JOVANI

